REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Me/Dana 21.10.2015 viti god.

| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|
| 01-013/1393 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 19.10.2015 aprovon këtë:

# V E N D I M
## PËR DHËNIEN E PËLQIMIT KOMPANISË PRIVATE "BLETA" SH.P.K. PËR HULUMTIM DHE SHFRYTËZIM NË FUSHËNE GJEOLOGJISË

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë JEP PËLQIM për hulumtim dhe shfrytëzim në fushën e gjeologjisë në parcelën nr 211-1 e cila gjendet në Zonën Kadastrale të Devajës në Komunën e Vitisë.

Neni 2

Pronarit të kompanisë i jepet pëlqimi për hulumtim dhe shfrytëzim në fushën e gjeologjisë, në vendin e quajtur Visoça i cili gjendet në Zonën Kadastrale të fshatit Devajë. Dhënia e këtij pëlqimi nuk nënkupton të drejtën për punë të mëtutjeshëm.

Neni 3

Pëlqimi i dhënë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë do ti shërbej Kompanisë "Bleta" SH.P.K. për marrjen e lejes për hulumtim dhe shfrytëzim në fushën ë gjeologjisë në vendin e quajtur Visoça, në Zonën Kadastrale Devajë, pranë ministrisë kompetente. Ky vendim për dhënien e pëlqimit për hulumtim dhe shfrytëzim në fushën e gjeologjisë vlen 6 ( gjashtë) muaj nga data e marrjes së vendimit nga Kuvendi komunal.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira